



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_ prot.,

Kamëz, më 18.04.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

**Drejtuar:** “R. S. & M” sh.p.k

**Adresa:** *Autostrada Tiranë-Durrës, km2, Tiranë, 1000*

**Procedura e prokurimit/lotit:** “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra”

**Numri procedures/ referenca e lotit:** REF-99189-03-25-2024

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Blerje boje dhe materiale speciale për vijëzime rruge”

**Fondi Limit:** 3,232,000 (tre milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 15 ditë

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme në kosto \_\_\_\_

oferta ekonomikisht më e favorshme në çmim  X

Me anë të këtij njoftimi, ju informojmë se, në këtë procedure kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **ALBANIA MOTORS**,sh.p.k, me NIPT: L92413031P, me vlerë të ofertës: 2,989,000 ( dy million e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH;
2. **Alb-Korrekt**, me NIPT: L61621027F, me vlerë të ofertës: 2,645,500 (dy million e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e pesqind) lekë pa TVSH;
3. **KALIA sh.p.k**, me NIPT: L41320036L, me vlerë të ofertës: 2,687,800 (dy million e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH;
4. **R.S. & M sh.p.k**, me NIPT: K32203002I, me vlerë të ofertës: 3,079,000 ( tre milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar operatorët e mëposhtëm:

1. **ALBANIA MOTORS**,sh.p.k, me NIPT: L92413031P, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

Mbështetur në ligjin nr. 162 “Për prokurimin publik” si dhe në DST ku specifikisht në shkronjën b, pika 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” kërkohet Sigurimi i ofertës sipas shtojcës 3 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës.

Pika 2.2.2, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur bilacin vjetor për vitin 2023 të kërkuar sipas kritereve të specifikuara në DST.

Pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi/distributor i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi.

Pika 2.3.3 Kapaciteti teknik nuk ka paraqitur katalog ose skeda teknike për bojën në gjuhën shqipe ose të përkthyer, e cila nuk plotëson kushtet sipas përcaktimeve në DST.

Pika 2.3.4 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas specifikimeve të kërkuara në DST, i cili përbën shkak për skualifikim.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162 “Për Prokurimin Publik”,

VKM, 285, date 19.05.2021, Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

DST

2. **Alb-Korrekt**, me NIPT: L61621027F, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

Mbështetur në ligjin nr. 162 “Për prokurimin publik” si dhe në DST ku specifikisht në shkronjën b, pika 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” kërkohet Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur formularin e sipërcituar.

Pika 2.2.2, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur bilacin vjetor për vitin 2023 të kërkuar sipas kritereve të specifikuara në DST.

Pika 2.3.3 Kapaciteti Teknik, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur katalog ose skeda teknike për fosforin dhe diluentin, e cila nuk plotëson kushtet sipas përcaktimeve në DST.

Pika 2.3.4 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas specifikimeve të kërkuara në DST, i cili përbën shkak për skualifikim.

Pika 2.3.5 Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur deklarat garancie për mallin objekt prokurimi

Baza ligjore:

Ligji nr. 162 “Për Prokurimin Publik”,

VKM, 285, date 19.05.2021, Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

DST

3. **KALLIA sh.p.k**, me NIPT: L41320036L, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

Pika 2.3.3 Kapaciteti Teknik, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog ose skeda teknike për bojrat, fosforin dhe diluentin në gjuhën shqipe ose të përkthyer, e cila nuk plotëson kushtet sipas përcaktimeve në DST.

Pika 2.3.4 Operatori ekonomik ka paraqitur mostrat në vendin dhe orën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor por në kundërshtim me specifikimet e kërkuara në DST, pasi boja e zezë akrelrike rezulton me datë skadence 02.2024, si dhe bojë bikomponente pastë e kuqe rezulton me datë skadence 09.03.2024, si dhe të gjitha bojërat e paraqitura pranë Autoritetit Kontraktor janë me datë skadence brenda vitit 2024 e cila bie ndesh me kriteret e kërkuara në DST.

Pika 2.3.5 Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur deklarat garancie për mallin objekt prokurimi konform kriterit të përcaktuar në DST, për një periudhë jo më pak se një vit nga data e lëvrimit të mallit, si dhe shkronja c) e pikës 2.3.3 e cituar nga OE nuk ekziston.

Baza ligjore:

Ligji nr. 162 “Për Prokurimin Publik”,

VKM, 285, date 19.05.2021, Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

DST

\*\*\*\*\*

Duke iu referuar procedurës së lart përmendur, informojmë operatorin ekonomik “**R.S.&M sh.p.k**, me NIPT: K32203002I”, se oferta e paraqitur me vlerën 3,079,000 ( tre milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

## TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**Eduart BODINI**

**Konc: Mevlud Shehu**